



ALBANIAN

Cfarë është një koronavirus?

Koronaviruset janë një familje e madhe virusesh që shkaktojnë sëmundje si tek kafshët ashtu edhe tek njerëzit; në këto të fundit, koronaviruset shkaktojnë infeksione të frymëmarrjes duke filluar nga ftohja e zakonshme deri tek sëmundjet më të rënda.

Cfarë është COVID-19?

COVID-19 është sëmundje infektive e shkaktuar nga koronavirusi i ri ("CO" lidhet me kurorë, VI lidhet me virusin, "D" lidhet me sëmundjen dhe "19" lidhet me vitin në të cilin u shfaq). Ky virus i ri dhe kjo sëmundje ishin të panjohura përpara se të manifestoheshin në Wuhan, në Kinë në Dhjetor 2019.

Cilat janë simptomat e një personi me COVID-19?

Simptomat më të zakonshme janë ethe, ndjesi lodhjeje dhe kollë e thatë. Në rastet me të rënda, infeksioni mund të shkaktojë pneumoni, sindromë të rëndë respiratore akute, madje edhe vdekje.

A ka mjekim ose vaksinë për COVID-19?

Jo, aktualisht nuk ka vakcina ose ilaçe specifike antivirale për të parandaluar ose trajtuar COVID-2019. Sidoqoftë të prekurit duhet të marrin mjekimin e përshtatshëm për trajtimin e simptomave, ndërsa ata me sëmundje të rëndë duhet të shtrohen në spital. Shumica e pacientëve shërohen falë ndihmës mbështetëse. Vaksinat e mundshme dhe disa trajtime specifike janë duke u studiuar.



Kush rrezikon të zhvillojë një sëmundje të rëndë?

Ndërsa ndikimi i COVID-19 tek njerëzit është duke u studiuar, njerëzit e moshuar dhe ata me kushte mjekësore para-ekzistuese, si hipertensioni, sëmundje të zemrës, sëmundje të mushkërive, kancer ose diabet, duket se zhvillojnë një sëmundje serioze më shpesh se të tjerët.

Cfarë mund të bëj për të mbrojtur veten time dhe për të parandaluar përhapjen e infeksionit?

Mund të zvogëloni shanset tuaja për t'u infektuar ose përhapur COVID-19 duke marrë disa masa paraprake të thjeshta:

- Lani shpesh duart me ujë dhe sapun ose pastrojini ato duke i fërkuar me dizinfektues me bazë alkooli për të eliminuar virusin nga duart tuaja.
- Mbani një distancë të caktuar – të paktën një metër – nga njerëzit e tjerë, veçanërisht kur kolliten ose teshtijnë ose nëse kanë ethe, sepse virusi gjendet në spërklat e pështymës dhe mund të transmetohet nëpërmjet frymëmarrjes në distancë të afërt.
- Shmangni prekjen e syve, hundës dhe gojës me duar sepse ato, duke prekur shumë sipërfaqe, mund të mbledhin virusin dhe, pasi të jenë kontaminuar, mund të transferojnë virusin te sytë, hunda dhe goja. Nga këtu, virusi lëviz në trup dhe mund t'ju bëjë të sëmurë.
- Ndiqni një higjienë të mirë të frymëmarrjes, d.m.th. mbuloni gojën dhe hundën me shami letre ose, në mungesë të shamisë, me gropëzën e bërrylit: spërklat në të vërtetë përhapin virusin, dhe duke ndjekur një higjienë të mirë të frymëmarrjes, mbroni njerëzit pranë jush nga viruset si ftohja, gripi dhe COVID-19.
- Shmangni shtrëngimet e duarve dhe përqaftimet, për shkak të arsyeve të sipërpërmendura.
Qëndroni në shtëpi sa më shumë që të jetë e mundur siç është vendosur nga autoritetet. Nëse keni ethe, kollë dhe vështirësi në frymëmarrje, telefononi mjekun tuaj i cili do t'ju referojë në shërbimin shëndetësor të duhur. Në këtë mënyrë, do të jeni më të mbrojtur dhe do të ndihmoni në kufizimin e përhapjes së viruseve dhe infeksioneve të tjera.



All the measures included in the present leaflet follow what established by the world health organization (WHO)

